



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 504/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Afijete Sada – Gllogjani kryesuese, Milena Đerić dhe Ferki Xhaferi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Florije Krasniqi-Pireva, duke vendosur përkitazi me ankesën e Sara Xhaka, komisionere nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dhe ankesën e Artan Rama komisioner nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive në ditën e votimit për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 14.02.2021 në seancën e panelit të mbajtur me 16.02.2021, mori këtë:

V E N D I M

HUDHEN të palejuara ankesat A.nr.504/2021 dhe Anr.512/2021 të datës 15.02.2021, të parashtruara nga Sara Xhaka, komisionere nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dhe ankesën e Artan Rama komisioner nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), për shkak të parregullsive në ditën e votimit për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 14.02.2021.

A r s y e t i m

Paneliai, me datë 15.02.2021, ka pranuar ankesat A.nr.504/2021 dhe Anr.512/2021, Sara Xhaka, komisionere nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dhe ankesën e Artan Rama komisioner nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në të cilat pretendohet se në ditën e votimit në Qendrën e Votimit në shkollën “Sveti Sava” në Mitrovicën e Veriut, ka pasur parregullsi gjatë votimit, ku persona të panjohur kanë votuar nga 2-3 herë radhazi. Këto parregullsi janë evidentuar në Librin e Vërejtjeve, dhe se komisionerja Sara Xhaka, nga radhët e subjektit politik LDK, ka refuzuar të nënshkruaj Formularin e Përputhjes së Rezultateve. Lidhur me këtë rast në këtë QV, ka arritur edhe Prokurori i Shtetit

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e palejuar

Paneli vlerëson se pretendimi i palëve ankuese edhe pse i referohen parregullsive në ditën e votimit, për shkak se përmes këtyre ankesave atakohet rezultati i cili është ende si rezultat

preliminar, e i cili rezultat mund të ndryshoj, ankesa në këtë fazë të procesit zgjedhor është e parakohshme, për shkak se pas publikimit të rezultatit përfundimtar i njëjti rezultat është i ankimueshëm nga subjektet politike edhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me numrin e votave të tyre. Meqenëse në aspektin kohor-faza e procesit zgjedhor kur parashtrohet ankesa është e parakohshme ankesa duhet të hudhet poshtë si e palejueshme.

Paneli, bazuar në nenin 8 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave Nr.02/2015, të PZAP-it, në të cilën përcaktohet se: *“Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave kryesuesi i panelit vendimmarrës mund të vendos ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme dhe se ato ankesa të trajtohen me një vendim”*, bëri bashkimin e ankesave dhe për të njëjtat vendosi me një vendim, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Në momentin e publikimit të rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, mund të ushtroj ankesën në afatin prej 24 orëve.

Bazuar në arsyet e sipërshënuara dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se *“PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet”* dhe Nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: *“Ankesat të cilat janë të palejuar dhe të pasafatshme PZAP-i i hudhë poshtë me vendim”*, lidhur me ankesën e lartë përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendosja sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi për hudhjen e ankesës të palejueshme nuk e prejudikon rezultatin përfundimtar e po ashtu me të njëjtat pretendime ankimore palët mund ta atakojnë/apelojnë rezultatin përfundimtar.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së dhe 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
A nr. 504/2019 më datën 16.02.2021

Kryesuese e Panelit
Afijete Sada Glogjani



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.